



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. l prot. 513 Më 06.06.2019
Br. prot. Dt. 2019
RAHOVEC - ORAHOVAC



02
04
4711
06.05.19

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transport

Prishtinë, 06.05.2019

Në bazë të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr 82, 21 tetor 2010), si dhe në bazë të nenit 8 paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 17 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloret nr.14/2017, Nr.15/2017, Nr.16/2017, Nr.07/2018, Nr. 22/2018, Nr. 26/2018 dhe Nr. 30/2018, nenit 25 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Ligjit Nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2019, lidhet ky:

**MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE
INFRASTRUKTURE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

**Neni 1
Palët Nënshkruese**

1. **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT**, e përfaqësuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, (në tekstin e mëtejshëm MIT),

dhe

2. **KOMUNA E RAHOVECIT**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejshëm Komuna).

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është financimi i projekteve infrastrukturore të cekura më poshtë si dhe përcaktimi i obligimeve të MIT-së dhe Komunës për realizimin e projekteve:

1. Ndërtimi i rrugës me katër Korsi nga Rahoveci - deri në Xërxe, kodi i projektit nr. 18189, në vlerë prej 3,400,000€. Ndarjet buxhetore për vitin 2019 janë 200,000€, ndërsa për dy vitet në vijim mjetet buxhetore të parashikuara janë 3,200,000€;

Neni 3 Obligimet e MIT-së

1. MIT-ja i siguron mjetet për projektet nga paragrafi 2 i këtij Memorandumi dhe nga një kopje i dërgon Komunës.
2. Pagesat për financim të projekteve nga MIT-ja do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës. Pagesat bëhen nga MIT-ja deri në vlerën e financimit.
3. MIT-ja cakton një zyrtar për mbikqyrjen e realizimit të projekteve nga fillimi deri në përfundim të kontratës. MIT-ja me vendim do të caktoj detyrat, përgjegjësitë dhe autorizimet e zyrtarit për mbikëqyrje.

Neni 4 Obligimet e Komunës

1. Komuna siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit dhe një kopje e dërgon në MIT.
2. Komuna obligohet t'i krijojë kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve për operatorët ekonomik, të ndërmarrë të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesë të fillojë në implementimin e projekteve me kohë si dhe të sigurojë specifikacionet teknike.
3. Komuna obligohet që projektet të zhvillojë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.
4. Komuna kryen procesin e tenderimit dhe cakton komisionin për hapjen e ofertave dhe vlerësim të tenderit, në të cilat komisione një anëtar duhet të jetë nga ana e MIT-së.
5. Komuna emëron Projekt Menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projekteve, si dhe komisionin për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik, në të cilin komision duhet të jetë një anëtar nga MIT-ja.
6. Projekt Menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.
7. Komuna obligohet që të njofton MIT-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projekteve dhe për këtë të kërkojë pëlqimin nga MIT-ja.

- 7.1. Komuna obligohet që në vend punishte të vendosë tabelën informuese (Pano) me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.
8. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga MIT-ja të kompletojë këto dokumente:
- 8.1. Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara);
 - 8.2. Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik, së bashku me ofertën financiare, të vërtetuara në bazë të origjinalit nga menaxheri i prokurimit të Komunës;
 - 8.3. Vendimi mbi emërimin e Projekt Menaxherit/organit mbikëqyrës dhe komisionin e pranimit nga ana e Komunës;
 - 8.4. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situationet e aprovuara);
 - 8.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MIT-ja dhe
 - 8.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK - Departamenti i Thesarit- Ministria e Financave).
9. Komuna duhet të ndërmarrë të gjitha masat që projektet të përfundojnë në përputhje me ndarjet buxhetore sipas viteve për projektin e tillë. Pas këtij afati të gjitha obligimet kalojnë në përgjegjësi të Komunës.
10. Komuna është e obliguar të njoftoj MIT-në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dy javor deri në përfundim të projektit.
11. Komuna obligohet të ndërmarrë dhe kryejë çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projekteve përfshirë procedurat dhe kompenzimin në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Ministrinë e Financave.

Neni 5

Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MIT-së dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MIT-ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga ky Memorandum.

Neni 6
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord reciprokisht për mënyrën e zgjidhjes së të gjitha çështjeve të pazgjidhura në këtë drejtim.

Neni 7
Numri i Kopjeve

Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) kopje origjinale, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 8
Pronësia e Projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga operatori ekonomik, pas pranimit teknik të projektit i njëjti do të kalojë në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 9
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që ky Memorandum i Mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Për:

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit

Pal LEK
Ministër



Komunën e Rahovecit

Smajl LATIFI

Kryetar

